



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 te nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimit Publik lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 02.08.2024 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K. nga Prishtina, bie këtë :

VENDIM

I

Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K. nga Prishtina e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 02.08.2024 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-24-5207-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-008-1-2-1 me titull: “**Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar**”

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K. nga Prishtina me datë 02.08.2024 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “**Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar**”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 7; 59; 60 dhe 62 të LPP-s si dhe është cekur se janë shkelur dispozitat e neneve 40 dhe 43 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s dhe rregullores, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues, është cekur se sa i përket arsyes së anulimit, sqarojmë se nuk është në kompetencë të njësisë kërkuese anulimi i procedurave të prokurimit, por përgjegjësitë e njësisë kërkuese janë të hartojnë specifikimet teknike dhe paramasën. Pavarësisht se çfarë shkrese ka dërguar njësia kërkuese, ZPP nuk mund të anulojë aktivitetin e prokurimit pa bazë ligjore dhe njësia kërkuese nuk është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit, prandaj kjo arsye e anulimit është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme.

Sikur e ka cekur edhe vetë O.E. ankues, njësia e kërkesës është përgjegjëse të hartojnë specifikimet teknike dhe paramasën. Por për shkak të gabimeve në paramasë të cilat i kanë vërejtur gjatë vlerësimit të tenderit, sepse është dorëzuar paramasa e vjetër (për pajisjet e vjetra) për laborator ku tashmë shumica e artikujve të kërkuar nuk përdoren edhe nuk hynë në funksion të aparateve në njësinë e analizave. Të njëjtit kanë bërë kërkesë që kjo procedurë e prokurimit të anulohet dhe të rishpallet pasi që të korrigjohen paramasat për shkak se shumica e artikujve të nevojshëm nuk do të mund të furnizohen, ndërsa në kontratë do të përfshiheshin shumë artikuj të pa nevojshëm.

Duhet të theksojmë që njësia e kërkesës nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nuk e ka anuluar procedurën e prokurimit në fjalë sikur ka pretenduar O.E. ankues, por pasi ka vërejtur që ka gabime në paramasë, ka kërkuar nga komisioni i vlerësimit dhe zyra e prokurimit që të anulohet procedura në fjalë dhe të rishpallet pas korrigjimit të paramasës (Shih kërkesën e bashkangjitur me njoftimin B58). Andaj pas analizimit të kërkesës, specifikave teknike si dhe provave dhe fakteve dhe pas konsultimit me njësinë e kërkesës, zyra e prokurimit me vendimin 02 nr.118-24 të datës 29.07.2024 duke u bazuar në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (i) të RREGULLORES 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK me qëllim të shmangies së shkeljes së ligjit vendosi që këtë procedurë të prokurimit ta anuloi dhe ta rishpall. (Shih vendimin e bashkangjitur me njoftimin B58)

Në pretendimin e dytë operatori ekonomik ankues ka cekur se po ashtu edhe arsyetimi se është bërë gabim tek dhënia e përqindjes së poentimit për artikuj të caktuar është arsyetim absurd dhe nuk ka mbështetje ligjore e as profesionale.

Përqindja për artikuj është dhënë sipas nevojave dhe kërkesave të AK-së, kur dihet fakti se këto janë parashikuar në fillim, para shpalljes së tenderit nga vetë autoriteti kontraktues dhe përderisa nuk është bërë hapja e ofertave nuk ka pas asnjë reagim as nga njësia kërkuese e as nga zyra e prokurimit. Sa i përket arsyetimit se kontrata në këtë mënyrë është e pazbatueshme, sqarojmë se ky konstatim është plotësisht i pasaktë dhe jo profesional e subjektiv, sepse kjo kontratë është e zbatueshme konform nevojave të AK-së. Hapja e ofertave është bërë me dt.01.07.2024, kurse njoftimi mbi vendimin është bërë me dt. 29.07.2024, e që ky fakt tregon qartë se nga data e hapjes janë analizuar në detaje ofertat dhe kur është konstatuar se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe jemi me çmim më të ulët, atëherë është inskenuar një veprim i tillë për të anuluar këtë tender dhe për të mos na rekomanduar neve për kontratë.

Konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që komisioni i vlerësimit ka filluar me vlerësimin e tenderit në fjalë dhe në momentin e paraqitjes së kërkesës nga njësia e kërkesës ka qenë pothuajse në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave por pasi ka pranuar kërkesën e datës 12.07.2024 ka rekomanduar që të anulohet procedura në fjalë për shkak të gabimeve në paramasë si dhe për shkak se nga njësia e kërkesës gjatë poentimit gabimisht është bërë dhënia e përqindjes së ponetimeve për artikuj të caktuar, pasi që në këta artikuj sasia e dhënë në përqindje është e pakët sepse tek artikujt më shumë të shfrytëzueshëm, kanë dhënë përqindjen më të vogël dhe si pasojë nuk mund të bëjnë furnizimet e mjaftueshme të cilat janë të domosdoshme për shfrytëzim.

Andaj zyra e prokurimit me rastin e anulimit të kësaj procedure nuk ka pasur për qëllim çfarëdo inskenimi për të anuluar këtë tender dhe për të mos e rekomanduar o.e. ankues për kontratë por qëllimi i vetëm ka qenë që të korrigjohen gabimet e cekura më lartë, pasi që kontrata në fjalë është kontratë kornizë e cila do të lidhet për një periudhë 36 mujore dhe për shkak të gabimeve njësia e kërkesës do të mbetet pa artikujt kryesorë sepse nuk do të mund të kërkohej furnizimi për pajisje të cilat nuk janë në funksion dhe pajisjet të me të cilat është duke operuar laboratorit i QKMF nuk do të mund të përdoren pa artikujt që i përshtaten atyre, kështu që edhe nëse do të nënshkruhej kontrata në fjalë, do të ishte e pa zbatueshme.

Në pretendimin e tretë O.E. ankues ka cekur se anulimin e kësaj procedure të prokurimit me këto arsye nuk mund ta kuptojmë ndryshe përveç se tendencë diskriminimi ndaj kompanisë tonë, kur kemi parasysh faktin se ne jemi ofertuesi më i lirë dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë Çmimin më të ulët me peshim, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Pra, duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë. Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe jemi me çmim më të ulët. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-së nuk e ka zbatuar këtë dispozitë duke na diskriminuar neve. Po ashtu nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë

pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në fjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. O.E. ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për shkak që në paramasë është lejuar që të vendosen vetëm dy shifra pas presjes dhjetore ndërsa ka kërkuar që të lejohen katër shifra pas presjes dhjetore. Pasi kemi shqyrtuar kërkesën për të lejuar vendosjen e katër shifrave pas presjes dhjetore, kërkesa për rishqyrtim është aprovuar. Gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente!

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përshtatje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të Rregullores për prokurimin publik 001/2022 të cilat parashohin:

Citat: “Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parane për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohej çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin komprometim të objektivitetit ose integritetit.
- e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
- f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.
- g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi

respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik. Për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase. Pra qëllimi i LPP-s është që të mbrohet buxheti i shtetit duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës. Ne nuk kemi rekomanduar për kontratë asnjë O.E. me çmim më të lartë se oferta e O.E. ankues për tu konsideruar shkelje sikur është cekur më lartë por me qëllim që të përmirësohet gabimi dhe të hartohen specifikat teknike dhe të vendosen poentimet e secilit artikull duke marrë për bazë nevojat e njësisë të kërkesës, është vendosur që kjo procedurë të anulohet dhe të rishpallet. Andaj na del se ne si AK nuk i kemi shkelur dispozitat e nenit 1 të LPP-s por i kemi respektuar me përpikëri dispozitat në fjalë.

Më tej O.E. ankues pretendon që janë shkelur edhe dispozitat e nenit 59 të LPP-s për shkak që sipas O.E. ankues, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë Çmimi më i ulët me peshim, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Nuk pajtohemi që janë shkelur këto dispozita të LPP-së pasi që nuk janë relevante me rastin tonë sepse nuk e kemi rekomanduar për kontratë asnjë Operator Ekonomik dhe nuk e kemi anuluar tenderin për shkak se nuk ka pasur tenderues të përgjegjshëm, por i njëjti është anuluar për shkak të gabimeve të pariparueshme të cekura më lartë.


Sa i përket dëmeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar, në dosje të tenderit shprehimisht është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre si dhe me rastin e anulimit të procedurës së prokurimit. O.E. ankues ka paraqitur si shpenzim shërbimet e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe për kërkesën për rishqyrtim me ç'rast ka deklaruar se ka pasur një dëm enorm pa paraqitur asnjë fakt se si janë shkaktuar këto dëme materiale. Pra edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 05.08.2024

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
në Komunën e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.